

V E N D I M
Nr.595, datë 29.12.1993

**PËR KRITERET E SHPALLJES SË KONKURSEVE ME KARAKTER KOMBËTAR E
LOKAL DHE DHËNIEN E ÇMIMEVE PËR TO**

Me propozimin e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Shpallja e konkurseve në fushën e kulturës, artit e sportit në shkallë kombëtare e lokale caktohet përkatësisht nga ministria dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse, nga këshillat e rretheve dhe bashkitë e qyteteve.

Fituesve të konkurseve në fushën artistiko-kulturore, sportive e të rinisë mund t'u jepen çmime në sende kulturore-artistike, në mjete pune ose në lekë.

2. Numri i çmimeve për çdo gjini mund të jetë 1 të parë, 2 të dytë dhe deri 3 të tretë, në varësi nga numri i veprave dhe lloji i veprimtarive të paraqitura në konkurse për çdo gjini; mund të jepen edhe çmime inkurajuese.

3. Shpërblime jepen edhe për anëtarët e jurive, të komisioneve të vlerësimit e të organizimit, të grupeve të punës, të festivaleve, konkurseve, ekspozitave, olimpiadave e garave kombëtare.

4. Vlefëta e çmimeve për konkurset, garat kombëtare e lokale, si dhe shpërblimet për juritë, komisionet e vlerësimit e të organizimit dhe grupet e punës, do të jetë në mbështetje të fondeve buxhetore që jepen.

5. Të shfrytëzohet edhe kontributi i fondacioneve, sponsorëve e donatorëve, dhënë për këtë qëllim.

6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.48, datë 5.4.1979, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.230, datë 15.7.1983, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 1.11.1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi